



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR SLLOVENINË

1. Informacioni bazë

Kryeqyteti:	Lubjanë
Popullsia:	1,999,000 banorë
Sipërfaqja:	20,273 Km
Gjuha:	Slllovenisht
Monedha:	Euro (EUR)
Niveli i papunësisë:	4.4%

2. Kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe informacioni për viza

Një i huaj që hyn në Republikën e Sllovenisë duhet të ketë një dokument udhëtimi të vlefshëm, si edhe vizë apo leje qëndrimi.

Kush nuk ka nevojë për vizë?

Shtetasit e BE/ZEE dhe shtetasit e vendeve të treta me të cilat Sllovenia ka një regjim të lirë vizash nuk kanë nevojë për vizë për të hyrë në Slloveni. Ata mund të qëndrojnë në këtë shtet për jo më shumë se 90 ditë në një periudhë kohore prej 6 muajsh, duke filluar nga dita e parë e hyrjes në vend.

Në bazë të marrëveshjeve bilaterale, shtetasit Kroatë mund të hyjnë në Slloveni me një kartë identiteti dhe nuk kanë nevojë për vizë.

Llojet e vizave

Autoritetet Sllovene mund të lëshojnë katër lloje vizash. Lloji i vizës tregohet në vizën pullë që vendoset në pasaportë në një vend të veçantë dhe shënohet me shkronjat A, B, C or D.

Shembuj të vendit ku tregohet lloji i vizës:

http://.mzz.gov.si/fileadmin/pageuploads/konzulara/vizumska_nalepka/vizum - tip_vizuma - ang.pdf

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



Vizë transit në aeroport - A

Kjo vizë mundëson ata të huaj të cilët duhet të qëndrojnë në zona ndërkombëtare transiti të një aeroporti ndërkohë që presin fluturimin tjetër, por nuk u lejon hyrjen në vend. Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë nuk kanë nevojë për viza aeroporti (A).

Vizë transit - B

Kjo vizë i jep të drejtën një të huaji që udhëton nga një vend në tjetrin të kalojë transit nëpërmjet territorit të Shengenit. Një vizë transit mund të nxirret vetëm nëse i huaji provon që ai ose ajo lejohet të hyjë në vendin tjetër të destinacionit pas qëndrimit të tij ose të saj në territorin e Shengenit. Një vizë transit mund të jepet për të kaluar një ose dy herë transit dhe, në raste të veçanta, për të kaluar shumë herë transit, me kushtin që asnjë kalim transit nëpërmjet vendit të mos kalojë numrin e ditëve të përcaktuara në kohëzgjatjen e seksionit të qëndrimit të vizë pullë. Vizat tranzit me ligj nuk mund të kalojnë 5 ditë.

Vizë afatshkurtër - C

Kjo vizë i jep të drejtën një të huaji të hyjë dhe të qëndrojë në territorin Shengen për turizëm, biznes, vizita personale apo qëllime të tjera për hyrje. Një vizë afatshkurtër mund të jepet për një, dy ose më shumë hyrje në vendin ku as një qëndrim i vetëm i pandërprerë, as kohëzgjatja e plotë e numrit të qëndrimeve të njëpasnjëshme nuk i kalon 90 ditë brenda një periudhe gjashtë mujore, duke filluar nga dita e hyrjes së parë.

Bazuar në Marrëveshjet për Lehtësimin e Vizave dhe në Marrëveshjet e Ripranimit ndërmjet BE-së dhe **Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë**, shtetasit e këtyre vendeve duhet të kërkojnë vizë C Shengen për të hyrë në Slloveni; megjithatë ata përfitojnë një tarifë të reduktuar vize (35 Euro në vend të 60 Euro). Shumë kategori të aplikantëve (familjarë të shtetasve rezidentë të ligjshëm, studentë dhe pensionistë, gazetarë etj) tani mund të marrin gjithashtu viza falas. Për kategori të caktuara personash p.sh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kërkesat për dokumentacion do të thjeshtohen. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (përfshirë këtu tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësuesi të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje për periudha të gjata vlefshmërie dhe mbajtësit e pasaportave diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Shihni hollësi në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0085:0095:EN:PDF> (për Shqipërinë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0097:0107:EN:PDF> (për Bosnjë dhe Hercegovinën)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0125:0135:EN:PDF> për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0137:0147:EN:PDF> për Serbinë

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0109:0119:EN:PDF> për Malin e Zi

Mbajtësi i vizës hyrëse (C) duhet të regjistrojë qëndrimin e tij/saj në rajonin përkatës të policisë brenda 3 ditëve. Mbajtësit që do të qëndrojnë në hotel, kamp apo ndonjë ambient tjetër janë të përjashtuar.

Vizë afatgjatë - D

Kjo vizë i lëshohet një të huaji që do të marrë një leje qëndrimi në Slloveni për t'u bashkuar me familjen e vet. Një pjesëtar familjeje që nuk është shtetas i Komunitetit Evropian mund të hyjë në Slloveni me një pasaportë të vlefshme dhe vizë afatgjatë D për t'u bashkuar me familjen që ka një shtetas i BE-së apo shtetas Slloven, me përjashtim kur i huaji është qytetar i një shteti me të cilin Sllovenia ka një regjim të lirë vizash ose kur ai ose ajo ka një pasaportë të vlefshme dhe një leje qëndrimi të lëshuar nga një shtet tjetër anëtar i BE-se, përveçse se në rastet kur përcaktohet ndryshe nga marrëveshje ndërkombëtare.

Tarifat për vizë

Tarifa e vizës është 35 ose 60 Euro. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Republikës së Sllovenisë mund të pranojnë tarifën për vizë në monedha të tjera të konvertueshme.

Tarifa e vizës kombëtare (Tip D) është 60 Euro

Ku të aplikoj?

Lista e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore Sllovene ku ju mund të dorëzoni aplikimin për vizë:
http://www.mzz.gov.si/en/embassies_diplomatic_missions_and_consulates_general/#c2428

Formulari i aplikimit http://www.mzz.gov.si/en/visa_information/application_form/

Përveç kësaj, ju mund ta dorëzoni aplikimin për vizë në një mision diplomatik apo zyrë konsullore të një shteti tjetër Shengen me të cilin është rënë dakord përfaqësimi.

Ambasada Sllovene në Maqedoni (Shkup) [Përgjegjëse për Shqipërinë]

Adresa: Vodnjanska 42 1000 Skopje, Macedonia

Tel: (+) 389 2 317 66 63

Fax: (+) 389 2 317 66 31

E-mail: vsk@gov.si

Shënim: Aplikantët për vizë mund të aplikojnë për vizë Sllovene në Ambasadën Hungareze në:

Rruga Skenderbeu 16.

Tirana

Tel: 00-355-4-232-238, 00-355-4-234-903

Fax: 00-355-4-233-211

E-mail: [mission.tia\(at\)kum.hu](mailto:mission.tia(at)kum.hu)

URL: www.mfa.gov.hu/emb/tirana

Ambasada Sllovene në Bosnjë-Hercegovinë (Sarajevë)

Adresa Bentbaša 7, 7100 Sarajevo

Tel: (+) 387 33 271 260 (+) 387 33 271 250

Fax: (+) 387 33 271 270

E-mail: vsa@gov.si

Faqe interneti: <http://sarajevo.embassy.si/en>

Zyra Konsullore Sllovene në Bosnjë-Hercegovinë (Sarajevë)

Adresa Bjelave 73, 71000 Sarajevo

Tel: (+) 387 33 251 790 (+) 387 33 251 795

Fax: (+) 387 33 204 318

Ambasada Sllovene dhe Zyra Konsullore në Kroaci (Zagreb)

Adresa Alagovićeva 30, 10000 Zagreb

Tel: (+) 385 1 63 11 000 (Seksioni konsullor: (+) 385 1 631 1014)

Fax: (+) 385 1 61 77 236 (Seksioni konsullor: (+) 385 1 468 0387)

E-mail: vzg@gov.si

Faqe interneti: <http://zagreb.embassy.si/en>

Zyra Sllovene Konsullore në Kroaci (Split)

Adresa Mažuranićevo šetalište 1, 21000 Split

Tel: (+) 385 21 389 224
Fax: (+) 385 21 389 224
E-mail: Generalni.konzulat.rep.slovenije@st.t-com.hr

Misioni Slloven në Kosovë (Prishtinë)

Adresa Str. Anton Ceta 6, 38000 Priština
Tel: (+) 381 38 246 255
Fax: (+) 381 38 246 256

Ambasada Sllovene dhe Zyra Konsullore në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (Shkup)

Adresa: Vodnjanska 42, 1000 Skopje
Tel: (+) 389 2 317 66 63 (Seksioni konsullor: (+) 389 2 317 87 30)
Fax: (+) 389 2 317 66 31 (Seksioni konsullor: (+) 389 2 317 65 11)
E-mail: vsk@gov.si

Konsullata Sllovene në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (Bitola)

Adresa: Ul. 29. Noemvri st 4/II, 7000 Bitola
Tel: +389 47 254138
Fax: +389 47 254138

Ambasada Sllovene në Mal të Zi (Podgoricë)

Adresa: PC Čelebić, Ulica 13. jula B.B., 81000 Podgorica
tel: (+) 381 81 208 020
Fax: (+) 381 81 237 095
E-mail: kpg@gov.si

Ambasada Sllovene dhe Zyra Konsullore në Serbi (Beograd)

Adresa: Pariska 15, 11000 Beograd
Tel: (+) 381 11 303 84 77 (Seksioni konsullor: (+) 381 11 303 84 70)
Fax: (+) 381 11 328 86 57 (Seksioni konsullor: (+) 381 11 328 86 55)
E-mail: vbg@gov.si (Seksioni konsullor: kgb@gov.si)

3. Imigracioni për qëllime punësimi

a) Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj (duke përfshirë edhe llojet e lejeve të punës, vizat e punës dhe kërkesat, si dhe autoritetet përgjegjëse)

Nëse nuk jeni shtetas i BE-së, mund të punësoheni në Slloveni vetëm mbi bazën e një **leje pune**, e cila lëshohet në përputhje me legjislacionin kombëtar Slloven. Një leje pune si rregull lëshohet mbi bazë të kërkesës së punëdhënësve, kështu që ju duhet të gjeni një punëdhënës që dëshiron t'ju punësojë ju së pari. Një punëdhënës e merr lejen e punës vetëm në bazë të disa kushteve. Kushti më i rëndësishëm është që të mos ketë kandidatë të përshatshëm të regjistruar në Shërbimin e Punësimit të Sllovenisë dhe që punësimi të mos shkaktojë ndonjë problem në tregun Slloven të punës. Zakonisht leja e punës nuk lëshohet për më shumë se një vit.

Ka tre lloje të ndryshme leje pune. **Leja personale e punës** mund të ketë vlefshmëri të ndryshme (të pa përcaktuar, 3-vjeçare dhe një-vjeçare) dhe ju jep mundësinë të futeni në tregun e punës. Ndryshe nga lejet e tjera të punës, leja personale e punës nuk varet nga situata në tregun e punës, kështu që ju le hapësira për të kërkuar dhe punuar me të njëjtat kushte si qytetarët Sllovenë. Kategoritë e personave të cilët mund të aplikojnë për leje personale pune janë: refugjatë, pjesëtarë të familjeve të shtetasve Sllovenë, anëtarë të familjeve të të huajve të cilët kanë një leje pune për një periudhë të pa përcaktuar kohe, të huaj të punësuar nga një

punëdhënës për një periudhë prej 5 vjetësh pa ndërprerje, persona të vetë-punësuar dhe persona me një leje qëndrimi të përhershëm. Lejet personale të punës nuk i nënshtrohen kufizimeve të kuotave.

Autorizimi për punësim është lloji më i zakonshëm i lejes së punës kur ju punësoheni nga një kompani. Si rregull, leja i kërkohet punëdhënësit dhe lëshohet me kusht që për atë punë të caktuar të mos ketë punëkërkes vendas apo persona, që në lidhje me të drejtat për punësim, gëzojnë status të njëjtë me shtetasit Sllovenë (duke marrë parasysh edhe prioritetet e vendosura në Aktin e Punësimit dhe Punën e të Huajve), dhe të mos jetë plotësuar kuota vjetore për këtë formë punësimi. Autorizimi për punë lëshohet për një periudhë kohe të specifikuar nga punëdhënësi në aplikim, por jo më shumë se një vit.

Autorizimi për punë i jepet personave të emëruar nga shteti i tyre; trajnime dhe trajnime të avancuara për të huaj, punonjës sezonalë, menaxherë; shërbime kontraktuese. Secila prej këtyre kategorive të ndryshme ka rregullore specifike në lidhje me vlefshmërinë e lejes, kushtet për dhënien e lejes dhe përjashtimet.

Disa shërbime kontraktuese mund kryhen **pa leje pune**, me kusht që këto shërbime të mos e kalojnë periudhën e përcaktuar të kohës. Megjithatë këto shërbime duhet të regjistrohen pranë Shërbimit Slloven të Punësimit nga klientët e shërbimit apo organizatorët e aktivitetit. Kategoritë janë si më poshtë: shërbime kontraktuese nga artistë dhe autorë profesionistë që ofrojnë argëtim e zbavitje individualisht ose në grup, shërbime panairesh tregtare, shërbime të shoqëruara me mallra dhe shërbime pas-shitjes dhe shërbime emergjence.

Aplikimet për lëshimin e **autorizimeve të punësimit** dhe **autorizimet për punë** për punonjësit sezonalë regjistrohen në parim te zyrat rajonale të Shërbimit Slloven të Punësimit aty ku punëdhënësi ka regjistruar zyrën e vet, ndërsa aplikimet e tjera regjistrohen në zyrën qendrore të Shërbimit Slloven të Punësimit, i cili vendos për dhënien e autorizimeve dhe lejeve

Leje e qëndrimit të përkohshëm për qëllim punësimi

Do t'ju duhet:

- Leje të vlefshme pune ose ndonjë leje tjetër e nevojshme në përputhje me ligjin që rregullon punësimin e të huajve, me përjashtim të rasteve ku ligji që rregullon punësimin e të huajve përcakton që dispozitat e këtij akti nuk zbatohen,
- Deklarata nga punëdhënësi, në rast se është leja e parë e qëndrimit, që ai ose ajo do të përfundojë një marrëdhënie apo kontratë pune me të huajin dhe do të përfundojë një kontratë punësimi kur do pasohet nga një rinovim i lejes,
- Dëshmi penaliteti e lëshuar nga vendi i origjinës,
- Dëshmi të fondeve të garantuara për të jetuar,
- Dëshmi të sigurimit shëndetësor,
- Fotokopje e noterizuar e pasaportës së vlefshme.

b) Sektorët e tregut të punës që kanë mangësi:

Ka kërkesa të pa përmbushura për punëtorë në ndërtim, punim metalesh, inxhinieri mekanike dhe sektorët e furnizimit me ushqim (katering), për specialistë në shkenca dhe teknologji dhe për personel të kujdesit shëndetësor (infirmierë dhe mjekë të specialiteteve të ndryshme).

Analistë dhe programues sistemesh informacioni

Inxhinierë mekanikë etj.

Mjekë

Infirmierë

Kuzhinierë

Punonjës të shërbimeve mbrojtëse të pa klasifikuar diku tjetër

Muratorë

Marangozë dhe mobilierë

Modelues metalesh etj.

Saldatore etj.

Përgatitës metalesh strukturore dhe ndërtues

Vegël-punues etj.

Mekanikë elektrike, montator dhe xhenerik

Shoferë kamionësh dhe maunash
Punëtorë ndërtimi dhe mirëmbajtjeje: rrugësh, digash dhe ndërtime të ngjashme
Punëtore ndërtimi

c) Faqet e internetit për të kërkuar punë

Njoftimet për punë nxirren në faqet e internetit të Shërbimit Slloven të Punësimit dhe EURES. Ato botohen gjithashtu edhe në të përditshmet (Delo, Dnevnik, Večer, Primorske novice, Gorenjski glas, Dolenjski glas), në radio dhe televizione.

<http://www.zaposlitev.net/delo.php> - faqja kryesore për punë në Slloveni

<http://www.mojedelo.com/delo/> - Njoftime për punë nga gazeta Delo. (Slovene)

<http://www.worktree.com/> - Worktree (Pema e punës)

<http://www.summerjobs.com/do/ehere> - Punë gjatë sezonit veror

<http://www.careersineurope.com/> - Karriera në Europë, për të diplomuar dhe ata që sapo kanë filluar karrierën

<http://www.expatriates.com/classifieds/slo/jobs/> - punë për të çatdhesuarit në Slloveni

http://www.anyworkanywhere.com/jcq_si.html

<http://slovenia.jobs.com/>

<http://si.3wjobs.com/>

http://www.neëaupair.com/browse_nannies_results.aspx?cntry=Slovenia%20&pg=0

4. Imigracioni për qëllime studimi

Sistemi i Arsimit

Arsimi bazë (fillor) është i detyrueshëm, falas dhe zgjat nëntë vjet. Shtetasit e huaj dhe ata Sllovene që nuk kanë shtetësi Sllovene, por që banojnë në Slloveni kanë të drejtën e arsimimit të detyrueshëm bazë sipas të njëjtave kushte që aplikohen edhe për shtetasit e Republikës së Sllovenisë. Mësimi i gjuhës Sllovene mund t'ju ofrohet fëmijëve imigrantë. Mësuesi/ja që pranon një nxënës të huaj është e detyruar të përgatisë një plan individual mësimi për punën që do bëjë me këtë nxënës. Kur ka nevojë për të mësuar një grup më të madh nxënësish, atëherë ofrohet një mësues/e e trajnuar posaçërisht me njohuri të gjuhës së tyre. Nxënësit imigrantë përfshihen gjithashtu edhe në klasa shtesë kur është e nevojshme. Sipas Aktit për Shkollimin Elementar (1996), mësimdhënia e gjuhës amtare dhe kulturave për fëmijët me shtetësi të huaj (që nuk kanë shtetësi Sllovene), dhe që jetojnë në Slloveni, duhet të ofrohet në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ndërsa mësimi i gjuhëve amtare të tyre dhe kulturave duhet të organizohet për fëmijët e shtetasve Sllovene që jetojnë në Slloveni, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuha Sllovene.

Arsimi i mesëm është i organizuar në shkolla të mesme profesionale dhe shkolla të mesme të përgjithshme. Programet janë falas dhe mund të zgjasin deri në 5 vjet. Arsimi përfundohet kur merret provimi përfundimtar (provimi i maturës).

Shtetasit e huaj i nënshtrohen të njëjtave kushte si dhe shtetasit Sllovenë me kusht që ata t'i ndjekin studimet në përputhje me parimin e reciprocitetit. Numri i vendeve për shtetasit e huaj përcaktohet mbi baza vjetore nga Ministria dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare. Në rast se parimi i reciprocitetit nuk aplikohet, atëherë shtetasit e huaj duhet të paguajnë tarifën e pagesës për shkollim.

Arsimi i lartë (pas të mesmes) përfshin studime akademike universitare dhe studime të orientuara profesionalisht dhe këto zgjasin nga 2 deri në 6 vjet.

Studentët e huaj që dëshirojnë të studiojnë në Slloveni, përveç kërkesave për pranim që aplikohen për studentët Sllovene, duhet të përmbushin edhe disa kërkesa:

- leje qëndrimi në Slloveni

- dëshmi të gjuhës Sllovene (në të kundërt ata mund të ndjekin një kurs 1-vjeçar për gjuhën Sllovene të organizuar nga Qendra e Gjuhës Sllovene si gjuhë e dytë <http://www.centerslo.net>)
- certifikatë mjekësore (lëshuar brenda 6 muajve të fundit);
- certifikatë për përfundimin e arsimit të mesëm,
- pagesa e tarifave të shkollimit dhe kujdesit shëndetësor.

Si rregull, vetëm të huajt me leje qëndrimi të përhershëm në Slloveni dhe që janë (ata apo prindërit e tyre) taksapagues nuk paguajnë tarifën për shkollim, si dhe qytetarët e vendeve me të cilat ka marrëveshje bilaterale me Slloveninë për përjashtimin nga pagesa e tarifës së shkollimit (parimi i reciprocitetit).

Qytetarë të tjerë mund të aplikojnë për bursa nga Qeveria Sllovene ose të aplikojnë direkt të fakulteti përkatës për t'u përjashtuar apo për të kërkuar reduktim të pagesës së shkollimit. Numri i vendeve për studentët e huaj është 5% i vendeve të shpallura për shtetasit Sllovene, ku të paktën gjysma e kësaj kuote prej 5% i jepet personave me kombësi Sllovene, por pa shtetësi Sllovene. Parimi i reciprocitetit është i vlefshëm për studentët e huaj.

a) Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të studentëve të huaj (vizë studenti, leje qëndrimi, e drejta për të punuar nëse është e vlefshme)

Studentët që vijnë nga vendet anëtare që nuk janë anëtare në ZEE duhet të marrin vizë studenti përpara se të arrijnë në Slloveni. Ju lutemi, sigurohuni që pasaporta të jetë e vlefshme të paktën 18 muaj dhe dorëzoheni aplikimin tuaj për vizë në kohën e duhur. Marrja e vizës mund të kërkojë rreth 60 ditë, ndonëse ajo zakonisht lëshohet brenda 4 javëve. Është e rëndësishme që juve të tregoni detajet e të njëjtës pasaportë me të cilën keni plotësuar formularin dhe që do të udhëtoni për në Slloveni.

Studentet e pranuar në çdo universitet Slloven do të marrin një letër zyrtare pranimit nga universiteti përkatës në gjuhën Sllovene dhe në Anglisht.

Ju duhet të dorëzoni aplikimin tuaj për vizë në Ambasadën Sllovene apo zyrat Konsullore në shtetin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur. Listën e ambasadave dhe zyrave konsullore mund ta gjeni në:

http://www.mzz.gov.si/en/embassies_diplomatic_missions_and_consulates_general/

Leje e qëndrimit të përkohshëm për qëllime studimi: Ju duhet:

- Certifikatë pranimit për studime, shkollim, specializim apo trajnim në nivel ekspertësh e lëshuar nga institucioni arsimor tek i cili jeni pranuar ose një certifikatë e lëshuar nga autoriteti shtetëror kompetent përgjegjës për zbatimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare apo bilaterale apo një autoritet që jep bursa, ose një certifikatë e lëshuar nga një organizatë kombëtare kompetente përgjegjëse për zbatimin e një programi të veçantë,
- Dokument që provon se keni fonde të mjaftueshme për të jetuar,
- Dokument që provon se keni sigurim shëndetësor,
- Dëshmi penaliteti lëshuar nga shteti juaj,
- Fotokopje e pasaportës së vlefshme.

Kontrolloni gjithashtu edhe në <http://www.ess.gov.si/ncips/estia/edu/InfoForeignStud.htm>

b) Bursa universitare dhe pas-universitare

Çdo vit akademik, studentët mund të aplikojnë për bursat e mëposhtme:

1. **Bursa profesionale**, normalisht ofrohen nga kompani të ndryshme. Ofertat për këto bursa publikohen zakonisht në mars nga Shërbimi Slloven i Punësimit. Kandidatët i çojnë aplikimet e tyre direkt te kompania e cila i ofron këto bursa.

2. Bursat kombëtare dhe bursat ZOIS

3. **Bursat e ofruara nga fondacione të ndryshme**, të cilat janë institucione private ose shtetërore. Qëllimi i fondacioneve është të mbështesë financiarisht kandidatët e suksesshëm dhe kriteret për të marrë bursa variojnë nga kriteret sociale, rajonale tek ato politike. Disa nga fondacionet janë Fondacioni dr Anton Trstenjak, Fondacioni Ana, Fondacioni Shkencor Silloven, Fondacioni Arsimor i Rajonit Pomurje, Fondacioni Ajda në Shoqërinë Fshatare, Fondi për Zhvillimin e Studentit të Fakultetit Ekonomik, etj. Tenderët për bursa normalisht botohen nëpër gazeta apo dhe në internet.

c) **Lista e universiteteve dhe kolegjeve kryesore**

Universiteti i Lubjanës: <http://www.uni-lj.si/>

Për informacione në lidhje me procedurat e aplikimit dhe pranimit në vitin e parë të studimeve në Universitetin e Lubjanës për studentët e huaj, ju lutemi vizitoni faqen e internetit:

<http://www.uni-lj.si/English/InternationalRelations/InfoForeignStudents.asp>

Universiteti i Mariborit: <http://www.uni-mb.si>

Universiteti i Primorskes: <http://www.upr.si>

Universiteti i Nova Goricës: <http://www.p-ng.si/si/>

Një listë e institucioneve arsimore të arsimit universitar dhe pas-universitar, si dhe të arsimit të mesëm profesional publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: <http://www.mvzt.gov.si/>

Institucionet e përzgjedhura të arsimit të lartë profesional

- [Kolegji profesional për catering \(catering\) Maribor](http://www.vs-gt.mb.edus.si/) <http://www.vs-gt.mb.edus.si/>
- [Kolegji për Hortikulturë](http://www.vsc.si/) <http://www.vsc.si/>
- [Shkolla Slovenj gradec](http://www.sc-sg.net/), Kolegj profesional <http://www.sc-sg.net/>
- [Shkolla ekonomike](http://esnm.si/), Kolegj profesional <http://esnm.si/>
- [Qendra Arsimore e Bioteknologjisë në Ljubljana](http://www.bic-lj.si/), Kolegj profesional <http://www.bic-lj.si/>
- [Shkolla për shkenca teknike](http://www.s-sess.kr.edus.si/) në Kranj <http://www.s-sess.kr.edus.si/>
- [Shkolla bujqësore GRM në Novo Mesto](http://vs.ksgrm.net/) <http://vs.ksgrm.net/>
- [Shkolla profesionale e Novo Mesto](http://www.sc-nm.com/scnm/) pas shkollës së mesme <http://www.sc-nm.com/scnm/>
- [Kolegji profesional në Maribor](http://www.doba.si/) <http://www.doba.si/>
- [Shkolla e teknologjise së drurit në Maribor](http://www.visjales-mb.org/), Kolegj profesional <http://www.visjales-mb.org/>
- [Shkolla Šentjur](http://www.sc-s.si/), Kolegj profesional <http://www.sc-s.si/>
- [Shkolla e lartë ekonomike Murska Sobota](http://www.ekonomskasolams.si/), Shkollë e mesme profesionale <http://www.ekonomskasolams.si/>
- [Kolegj profesional për catering dhe turizëm në Bled](http://www.vgs-bled.si/) <http://www.vgs-bled.si/>
- [Shkolla tregtare dhe e biznesit në Celje](http://www.pksola.com/) <http://www.pksola.com/>
- [Shkolla teknike në Nova Gorica](http://www.s-tsc.ng.edus.si/) <http://www.s-tsc.ng.edus.si/>
- [Shkolla tregtare në Celje](http://www.vks-celje.si/) <http://www.vks-celje.si/>
- [Shkolla e teknologjisë së ushqimit](http://www.zivilska.si/) <http://www.zivilska.si/>

d) Programet për studentët e huaj kur është janë të zbatueshme

Ad futura: Zhvillimi i Burimeve Njerëzore Sllovene dhe fondi i bursave

<http://www.ad-futura.si/>

Fondacioni *Ad futura* është një agjenci që nxit bashkëpunimin ndërkombëtar dhe lëvizshmërinë e studenteve dhe studiuesve në Slloveni. Nëpërmjet kërkesave për aplikime, ai ofron bursa dhe bashkë financon studimet dhe kërkimet shkencore si të shtetasve Sllovenë ashtu edhe të të huajve në Slloveni. Gjithashtu ai financon rikthimin e studiuesve Sllovenë të cilët kanë kaluar disa vite duke punuar jashtë shtetit. Përveç bashkë-financimit, *Ad futura* organizon kongrese për studentët Sllovenë jashtë vendit dhe konferenca për studentët dhe organizatat e huaja.

Qendra e Republikës së Sllovenisë për Lëvizshmërinë dhe Programet e Trajnimit dhe Edukimit (CMEPIUS)

<http://www.cmepius.si/>

Qendra e Republikës së Sllovenisë për Lëvizshmërinë dhe Programet e Trajnimit dhe Edukimit (CMEPIUS) koordinon programet e trajnimit dhe arsimimit të Komunitetit Europian siç janë Leonardo da Vinci dhe Socrates, si dhe programe dypalëshe e shumëpalëshe dhe bursa ndërkombëtare. CMEPIUS mundëson gjithashtu edhe marrjen e bursave nga Sllovenë që jetojnë në vendet fqinjë dhe me prejardhje Sllovene nëpër botë. Informacionin mbi studimin dhe kërkesat e bursës së studimit për pasardhësit e emigrantëve Sllovenë dhe kandidatëve nga vendet kufitare mund ta gjeni në www.cmepius.si. CEEPUS – Programi i Shkëmbimit është aktiv brenda CMEPIUS me qëllimin për të filluar dhe inkurajuar lëvizjen e studentëve dhe profesorëve në Europën Qendrore.

5. Leja e Qëndrimit

Nëse planifikoni të qëndroni në Slloveni për një periudhë më shumë se tre muaj, ju duhet një leje qëndrimi.

Një leje qëndrimi mund të jetë e përhershme (pa kufizime përsa i takon periudhës së vlefshmërisë dhe qëllimit të qëndrimit) ose e përkohshme (e lëshuar për një periudhë të kufizuar kohe dhe me një qëllim të përcaktuar, specifik). Leja e parë e qëndrimit jepet si një leje qëndrimi e përkohshme të cilën duhet ta merrni përpara se të hyni në Slloveni.

Aplikimi për leje qëndrimi mund të bëhet në një mision diplomatik-konsullor të Sllovenisë ose në një njësi vendore Administrative me një pasaportë të vlefshme apo kartë identiteti. Aplikimi për një leje të qëndrimi të përhershëm mund të dërgohet pranë njësisë administrative në zonën tuaj të banimit në Slloveni.

Qe të aplikoni për një leje qëndrimi të përkohshëm, në Slloveni, ju duhet të tregoni një qëllim të qartë për qëndrimin tuaj në Slloveni, si për shembull:

- punësim
- bashkim familjar me një pjesëtar që ka leje qëndrimi
- të keni statusin e rezidentit afatgjatë në një shtet tjetër anëtar të BE-së
- studime, arsimim, specializim apo trajnim profesional, dhe aftësim praktik, pjesëmarrje në programe ndërkombëtare vullnetare shkëmbimi dhe programe të tjera të cilat nuk varen nga sistemi formal i arsimimit
- arsye të tjera të pranueshme të përcaktuara me ligj, akte ndërkombëtare apo parime ndërkombëtare
- origjinë Sllovene (deri në brezin e tretë me prejardhje të drejtpërdrejtë)

Në rast punësimi, ju duhet të dorëzoni konfirmim nga punëdhënësi juaj që ai/ajo do t'ju punësojë apo një dokument punësimi (kontrata e punës). Në rast studimi, vetë punësimi ose daljeje në pension duhet të paraqiten dokumente që e provojnë këtë gjë. Duhet gjithashtu të provoni që keni mjetet e duhura financiare për të jetuar si dhe sigurim shëndetësor.

Bashkangjitur me aplikimin tuaj për leje qëndrimi ju duhet të keni edhe dokument që tregojnë se mund të banoni në adresën që po regjistroni, si për shembull certifikata e pronësisë, të ardhura të garantuara rregullisht, pension, punësim dhe burime të tjera të ardhurash. Nëse merrni një banesë në Slloveni me një adresë dhe vendndodhje specifike, ju duhet ta regjistroni banesën tuaj dhe po ashtu çdo ndryshim banese, si dhe të çregjistroheni kur ikni nga Sllovenia – të gjitha këto pranë njërës prej njësive administrative.

Nëpërmjet regjistrimit të banesave të të huajve, mbi bazën e një leje që ju lejon të banoni në Slloveni juve do të merrni një numër kombëtar identiteti (EMŠO) që lëshohet nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Popullsisë, e cila shërben si bazë për pagesën e taksave, përdorimit të sistemit bankar dhe çdo lloj tjetër biznesi në Slloveni. Pas marrjes së EMŠO ju mund të regjistroheni, të njoftoni për ndryshim adrese dhe ta çregjistroheni rezidencën tuaj nëpërmjet faqes elektronike qeveritare.

Nëse ju qëndroni për pesë vjet pa ndërprerje në Republikën e Sllovenisë mbi bazën e lejes së qëndrimit të përkohshëm ju mund të aplikoni për një leje qëndrimi të përhershëm. Nëse keni qëndruar në Slloveni për: punë sezonale, si punonjës i kontraktuar apo si punëtor migrant ditor apo mbi bazën e një mbrojtjeje të përkohshme, kjo nuk llogaritet sipas kërkesës për 5 vjet qëndrimi. Nëse qëndroni në Slloveni si student, koha e studimit llogaritet si 50% e kohës së kërkesës.

Një leje për qëndrim të përhershëm mund t'u lëshohet përpara skadimit të periudhës pesë-vjeçare:

- personave me prejardhje Sllovene
- personave qëndrimi i të cilëve në Republikën e Sllovenisë është në interes të Republikës së Sllovenisë
- anëtarëve të afërt të familjeve të personave me leje qëndrimi të përhershëm apo me status refugjati në Slloveni
- personave të cilët e kanë pasur një leje qëndrimi të përhershëm, e cila është ndërprerë për shkak të largimit nga vendi apo mungese nga vendi apo zona e Bashkimit Europian, ose për shkak të marrjes së statusit të një rezidenti afatgjatë në një shtet tjetër anëtar të BE-së.

Qeveria e Sllovenisë përcakton çdo vit numrin (kuotën) e lejeve të qëndrimit që mund të lëshohen në një muaj të caktuar. Kuotat nuk përfshijnë lejet e qëndrimit të përkohshëm të lëshuara për qëllime të bashkimit familjar ose të lëshuara për të afërmin e qytetarëve Sllovenë, gazetarëve të akredituar dhe artistëve.

Për më shumë informacion shikoni në:

http://www.mnz.gov.si/en/splosno/stara_vstopna_stran/for_foreigners/upravne_notranje_zadeve/aliens/residence_permit_for_aliens_in_the_republic_of_slovenia/#c5576

6. Procedurat e Azilit

Dëshira për të kërkuar azil mund të shprehet tek autoritetet kufitare, në Zyrën e Azilit, pranë autoriteteve lokale, rajoni i policisë apo çdo organi tjetër shtetëror, si dhe në misionet diplomatike dhe konsullore të Sllovenisë.

Punonjësi i policisë duhet menjëherë t'ju drejtojë tek Zyra e Azilkërkuesve dhe t'i dërgojë një aplikim së bashku me të dhënat përkatëse autoritetit kompetent. Një përkthyes dhe një këshilltar ligjor mund të jenë të pranishëm nëse ju dëshironi.

Azilkërkuesit kanë të drejtë të:

- Qëndrojnë në Slloveni derisa të përfundojnë procedurat e azilit
- Sigurojnë kushtet bazë të jetesës
- Kujdes shëndetësor bazë
- Asistencë financiare
- Asistencë ligjore falas
- Ndihmë humanitare

Ndërkohë që ju prisni që Ministria të nxjerrë vendimin, fëmijët tuaj kanë të drejtë të arsimohen në shkollat fillore të Sllovenisë.

Detyrimet gjatë procedurës

Aplikantët për azil duhet:

- Të zbatojnë ligjet dhe rregulloret e tjera në Slloveni
- Të jenë gjithmonë lehtësisht të kontaktueshëm me autoritetet kompetente
- T'i përgjigjen urdhrave të autoriteteve kompetente dhe të bashkëpunojnë me to përgjatë gjithë fazave të procedurave të azilit
- Të lajmërojnë autoritetet që merren me azilkërkesit për çdo ndryshim adrese brenda tre ditëve pas lëvizjes dhe
- Të zbatojnë urdhrat e lëshuar nga autoritetet kompetente në lidhje me lëvizjen e kufizuar.

Pasi aplikimi të jetë marrë nga Ministria e Brendshme, një punonjës do të bëjë një intervistë e cila do e ndihmojë atë për të mbledhur gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kërkesën tuaj për azil. Ju do të keni një këshilltar ligjor si dhe një përkthyes të pranishëm gjatë gjithë fazave të procesit. Mbi bazë të informacionit që ju keni dhënë si dhe informacionit të mbledhur nga Ministria e Brendshme, do të merret një vendim nga Ministria e Brendshme nëse do t'ju jepet statusi i refugjatit apo jo.

Nëse ju jepet statusi i refugjatit, ju lind e drejta të keni:

- Qëndrim të përhershëm
- Asistencë financiare
- Strehim
- Kujdes shëndetësor
- Shkollim dhe arsimim
- Asistencë për integrim
- Leje pune dhe përfshirje në programe për kërkim aktiv pune

Kohëzgjatja e statusit të refugjatit

Në përputhje me Konventën për Statusin e Refugjatit të vitit 1951, statusi mund të përfundojë nëse arsyet për të cilat juve ju është dhënë azili nuk ekzistojnë më në vendin tuaj të origjinës. Sipas Ligjit për Azilin statusi juaj do të përfundojë nëse juve migroni apo merrni shtetësinë nga Sllovenia apo ndonjë shtet tjetër, ose nëse ktheheni me dëshirën tuaj në vendin nga i cili keni ardhur.

Nëse aplikimi juaj refuzohet, keni të drejtën të ankoheni ndaj vendimit të Gjykatës brenda 15 ditëve pas marrjes së vendimit për refuzim me shkrim. Sapo të merrni vendimin negativ, ju menjëherë duhet të kontaktoni këshilltarin tuaj ligjor.

7. Bashkimi familjar

Viza afatgjatë D i jepet pjesëtarëve të familjes të një vendi të tretë të shtetasve të BE-së apo atyre Sllovenë, me përjashtim të rasteve kur i huaji është qytetar i një vendi me të cilin Sllovenia ka një regjim të lirë vizash ose kur ai ose ajo ka një pasaportë të vlefshme dhe një leje qëndrimi të lëshuar nga një Shtet tjetër Anëtar i BE-së.

Bashkimi familjar është i mundur vetëm nëse një i afërm ka një leje qëndrimi të përhershëm ose ka pasur leje qëndrimi të përkohshëm gjatë vitit të fundit.

Aplikimi për një leje qëndrimi të përkohshëm për qëllime bashkimi familjar duhet të dërgohet në emër të anëtarit të familjes nga një shtetas Slloven ose shtetas i BE-së me vendbanim të regjistruar në Republikën e Sllovenisë ose nga një i huaj i cili ka një leje qëndrimi të përhershëm ose të përkohshëm në Republikën e Sllovenisë (kjo nuk vlen për të huajt që kanë leje qëndrimi të përkohshëm për qëllime punësimi sezonal).

Aplikimi duhet të dërgohet ose pranë një përfaqësie diplomatike-konsullore Sllovene jashtë shtetit ose pranë njësisë administrative në zonën ku anëtari i familjes do të qëndrojë pas ardhjes në Republikën e Sllovenisë.

Anëtarit të familjes i jepet një leje qëndrimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie sa edhe periudha e qëndrimit të përkohshëm e të huajt i cili po kërkon të drejtën për integrim familjar.

Aplikimi duhet të shoqërohet edhe me:

- Certifikatë martesë e cila duhet të jetë lëshuar tre muajt e fundit,
- Certifikatë lindjeje e fëmijëve,
- Vërtetim i fondeve të mjaftueshme për të jetuar,
- Dokument për sigurimin shëndetësor për anëtarët e familjes,
- Dëshmi penaliteti për personin e rritur me të cilin keni lidhje gjaku, të lëshuar nga vendi amë,
- Fotokopje të certifikuara të pasaportave të vlefshme të anëtarëve të familjes.

8. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor

Sigurimet shëndetësore

Sigurimet shëndetësore të detyrueshme përbëhen nga sigurimi për sëmundje apo dëmtime jashtë orarit të punës, dhe sigurimi për dëmtime në punë si dhe sëmundje profesionale. Përveç sigurimeve të detyrueshme shëndetësore, të cilat jepen nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë, ju mund të bëni gjithashtu **sigurim shëndetësor vullnetar** që ofrohet nga kompani sigurimi në rast se doni shtesa të tjera.

Karta e sigurimit shëndetësor është një dokument personal elektronik që duhet të paraqitet kur shkoni për vizitë të mjeku. Karta lëshohet falas për çdo person pas marrjes së sigurimit të detyrueshëm shëndetësor. Vlefshmëria e kartës përditësohet nga vetë mbajtësit e kartës në mënyrë të pavarur, nëpërmjet kompjuterit me vetë-shërbim që është instaluar në spitale apo institucione të tilla të ngjashme.

Kujdesi shëndetësor parësor në Slloveni ofrohet nga qendrat shëndetësore dhe farmacitë. Qendrat shëndetësore ofrojnë kujdes parandalues (për të rritur, fëmijë dhe të rinj), shërbime mjekësore të urgjencës, mjekim të përgjithshëm, kujdes shëndetësor për gra, fëmijë dhe të rinj, shërbime laboratorike dhe diagnostikuese. Klinika private mund të ofrojnë gjithashtu shërbime të kujdesit shëndetësor parësor. Gjithkush zgjedh mjekun e vet të përgjithshëm dhe dentistin. Gratë zgjedhin edhe gjinekologun e tyre. Përgjithësisht, qendrat e kujdesit shëndetësor kanë edhe farmaci nga ku mund të merren edhe mjekimet. Ilaçe pa recetë mund të merren gjithashtu nga këto farmaci.

Aktivitetet e specializuara për pacientë jashtë spitalit mbulojnë diagnostikimin, trajtimin dhe rehabilitimin mjekësor, mbështetje të kujdesit shëndetësor, akomodim dhe ushqim. Spitalet mund të jenë të përgjithshëm ose të specializuara. Pacientët shkojnë ose në një spital të përgjithshëm ose në një spital të specializuar në varësi të rekomandimit që kanë marrë nga mjeku i tyre i përgjithshëm.

Format më komplekse të trajtimeve të specializuara kryhen nga klinika dhe institute. Në shumicën e rasteve trajtimi nga specialisti është falas; pagesa shtesë kërkohet për disa raste dhe shërbime të veçanta, veçanërisht kur kemi të bëjmë me përfshirjen e shërbimeve private.

Numri i telefonit të urgjencës dhe ambulancës është 112. Në Slloveni ju mund të merrni shërbimin e nevojshëm mjekësor me anë të Kartës Europiane të Sigurimit Shëndetësor ose certifikatave të tjera të përshtatshme, me kartën e shërbimit shëndetësor që merret nga kushdo që është i siguruar në bazë të skemës së sigurimit shëndetësor të detyrueshëm në Slloveni. Çdo person konfirmon vlefshmërinë e kartës nëpërmjet kompjuterit me vetë-shërbim që është instaluar në spitale apo institucione të tilla të ngjashme.

Më shumë informacion mund të gjeni:

Instituti i Sigurimit Shëndetësor të Sllovenisë: <http://www.zzs.si/>

Kompania e Sigurimeve Triglav: <http://www2.zav-triglav.si>

Kompania e Sigurimeve Shëndetësore Vzemna: <http://www.vzemna.si/>

Kompania e Sigurimeve Adriatic: <http://www.adriatic-slovenica.si/>

Asistenca Coris: <http://www.coris.si>

9. Sistemi i sigurimeve shoqërore

Sistemi i sigurimeve shoqërore në Slloveni bazohet në pagesën e kontributit të dy palëve, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Në Slloveni, paguhen kontributet për sigurimet shëndetësore (shih me sipër), sigurim për pension dhe invaliditet, barrë lindje, sigurim papunësie, sigurim për aksident në punë dhe sigurim për sëmundje profesionale. Sipas Aktit të Sigurimit Shoqëror, të huajt që kanë leje qëndrimi të përhershëm në Slloveni kanë të drejtën e shërbimeve sociale. Të huajt të tjerë që nuk kanë leje qëndrimi të përhershëm në Slloveni gëzojnë të drejtën për shërbime individuale dhe ndihmë financiare në rastet dhe sipas kushteve të vendosura në Aktin për Sigurimet Shoqërore, ose mbi bazën e traktateve dypalëshe dhe shumëpalëshe të nënshkruara nga Sllovenia.

Skema e sigurimeve shoqërore në Slloveni është një skemë kontribuuese për të gjithë personat **e punësuar** dhe **vetëpunësuar**. Kontributet janë të përcaktuara sipas Ligjit për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore. Ky ligj përcakton nivelin e kontributeve që duhen paguar nga punëdhënësi dhe atë që duhet paguar nga i punësuari. Këto janë kontribute për papunësi, për barrë lindje, sigurim për sëmundje, për pension dhe sigurim për paaftësi, sigurim për dëmtime në punë dhe sëmundje profesionale.

Leja e lindjes zgjat 105 ditë. Nënata marrin kompensim lindjeje të përcaktuar mbi bazë të mesatares së rrogës gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. Babai ka të drejtë për **leje lindjeje** prej 90 ditësh. Njëri nga prindërit gëzon të drejtën e **lejes për kujdesin ndaj fëmijës** në mënyrë që të kujdeset për fëmijën për një periudhë prej 260 ditësh menjëherë pas mbarimit të lejes së lindjes.

Nëse humbni vendin e punës keni të drejtën e **përfitimit të papunësisë**. Kushti është që në 18 muajt e fundit ju duhet të keni qenë i punësuar nga një apo disa punëdhënës për të paktën 12 muajt, të keni qenë i siguruar për papunësi dhe të mos keni punë të përshtatshme për momentin. Pasi ju ka mbaruar kontrata e punës, keni 30 ditë për t'u regjistruar pranë shërbimit të punësisimit dhe të fusni një aplikim që të përfitoni nga përfitimet e papunësisë.

Për sa kohë merrni përfitimin e papunësisë kjo varet nga sigurimet tuaja të mëparshme suplementare, periudha që varion nga 3 muajt deri në 24 muajt. Në tre muajt e parë përfitimi i papunësisë është në një shumë deri në 70% dhe muajt e tjerë deri 60% të pagës tuaj mesatare të marrë në 12 muajt e fundit para se të dilnit si i papunë, më pak taksa dhe kontribute.

10. Strehimi

Për gjetjen e vendeve të banimit mund t'ju ndihmojnë agjenci private që merren me shitje, blerje apo dhënie me qira të pasurive të paluajtshme, ose mund të shikoni njoftimet që dalin në mediane dhe internet. Nëse vendosni të merrni një apartament me qira, duhet të bëni një marrëveshje me pronarin e cila noterizohet nga një noter.

Çmimet e pasurive të paluajtshme dhe qiratë e apartamenteve varen nga vendndodhja, mobilimi dhe vjetërsia e apartamentit. Çmimet janë me të larta në Lubjanë dhe përreth saj, në Koper, Maribor dhe Celje. Qiraja zakonisht nuk përfshin kostot e përditshme (energjinë elektrike, gazin ujërë, telefonin, ngrohjen dhe mbledhjen e plehrave). Normalisht paguhet si fillim një qira tre mujore si depozitë.

Për më shumë informacion vizitoni faqet e internetit:

<http://www.abc-nepremicnine.si>
<http://www.realestate-slovenia.info>

11. Njohja e diplomave

Nëse keni marrë një shkollim të veçantë jashtë shtetit dhe dëshironi që ai t'ju njihet në Slloveni sepse doni të punoni atje, ju duhet të bëni një aplikim për njohje **shkollimi për qëllime punësimi** (në formularin Z) për ministrinë përkatëse. Nëse keni një diplomë të shkollës së mesme, dërgojeni aplikimin tuaj tek Ministria e Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë. Nëse nuk keni arsim të lartë, diplomë apo certifikatë, dërgojeni aplikimin tuaj tek Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Dokumentet e mëposhtme duhen përfshirë së bashku me aplikimin: dokument i arsimit i përkthyer në gjuhën Sllovene dhe i legalizuar, si dhe origjinali i tij. Duhet gjithashtu edhe një përshkrim i shkurtër kronologjik i gjithë periudhës tuaj të arsimit. Ministria përkatëse do të nxjerrë vendimin brenda dy muajve nga data e futjes së aplikimit të përfunduar. Për vendimin e marrë nuk ka mundësi për t'u ankuar, por është i mundur një kontestim administrativ; mund të ngrihet një çështje ligjore pranë një gjykate Administrative kompetente.

Nëse keni një shkollim të veçantë jashtë shtetit dhe dëshironi të vazhdoni studimet tuaja në Slloveni, duhet të dërgoni një aplikim për **njohje arsimit për qëllime vazhdimi studimesh** (në formularin N) pranë shkollës apo universitetit tek i cili ju doni të vazhdoni studimet. Shkolla do të marrë një vendim mbi bazën e të cilit ju do të jeni në gjendje të futeni tek programi i duhur arsimor në Slloveni. Ankesa kundrejt vendimit mund të bëhet pranë bordit të shkollës ose senatit.

Është e mundur gjithashtu të merrni një opinion në lidhje me vlerësimin e certifikatave dhe diplomave të marra në **republikat e ish Federatës Socialiste Jugosllave përpara 25 Qershorit 1991** për të krahasuar nivelin e arsimit të marrë me nivelin dhe disiplinën në Slloveni. Formulari i Aplikimit V përdoret për të dërguar një aplikim për vlerësim, duke treguar elementet që duhen vlerësuar. Ky dërgohet në Ministrinë kompetente (Ministria e Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë)

Më shumë informacion do të gjeni rre:

Ministria e Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë:

http://www.mvzt.gov.si/en/areas_of_work/recognition_and_assessment_of_education/general/#c895

Zyra e Njohjes së Arsimit

Kotnikova 38

1000 LJUBLJANA

Tel.: (01) 478 47 45 (nëse telefonon nga jashtë: 00 386 1 478 47 45)

Fax.: (01) 478 47 24 (nëse telefonon nga jashtë: 00 386 1 478 47 24)

E-mail: naric.mvzt@gov.si

Faqe interneti ENIC/NARIC: <http://www.enic-naric.net>

12. Shërbime mbështetëse të ofruara për migrantët

Shoqata Ključ (Key)

Shoqëria Ključ ofron kujdes dhe programe integrimi për viktimat e trafikut.

Društvo Ključ

p.p. 1646

1001 Ljubljana

email: info@drustvo-kljuc.si

Tel: 00386 80 17 22 (numër pa pagesë)
ditët e punës 9.00 – 1. 00.
<http://drustvo-kljuc.si/indexen.php>

Fondacioni Gea 2000 Rrjeti i avokatëve për Azilin

GEA 2000 është një organizatë jo-qeveritare me qëllimin për të ofruar asistencë të përgjithshme dhe përkrahje sociale në fushën e mbrojtjes dhe ndihmës humanitare dhe asaj të mjedisit.

Mestni Trg 9
1000 Ljubljana
Tel.: + 386 / 01 241-05-40 + 386 / 01 421-35-60
Fax: + 386 / 01 421-35-65
E-mail: fundacija@fundacija-gea2000.si
http://www.fundacija-gea2000.si/index_eng.php

Filantropia Sllovene, Qendra për Ndihmë psiko-sociale për Refugjatët

Poljanska 12, 1000 Ljubljana
tel: 386 (0)1 430 1288, 433 4024, 433 5106
fax: 386 (0)1 430 1289
E-mail: info@filantropija.org
<http://www.filantropija.org/> (slovenisht)

Caritas Slloven

Caritas Slloven (Slovenska karitas) është një organizatë bamirësie e Kishës Katolike Romane në Slloveni.

Kristanova 1
1000 Ljubljana
Slovenia
tel.: +386 1 300-59-60
fax: +386 1 232-31-86
e-mail: info@karitas.si
<http://www.karitas.si>
Lista e degëve lokale gjendet në: http://www.karitas.si/predstavitev/index_eng.php

Kryqi i Kuq Slloven

Red Cross Slovenia
Mirje 19
1000 Ljubljana
tel 01/ 24 14 300
fax 01/ 24 14 344
E-mail: rdec.kriz@rks.si
<http://www.rks.si/sl/English/?rks-frontend=g64fpgsilfd7dvu7vct4oiu8d6>

Numrat e telefonit të drejtpërdrejtë 24 orë për viktimat e dhunës në familje dhe trafikut

- 113 POLICIA (falas)
- 00386 80 17 22 (falas)
ditët e punës 9 a.m. – 1 p.m.
Një ekspert i Shoqërisë Ključ do i përgjigjet telefonatave tuaja. Telefonata mund të jetë anonime
- 00386 31 613 000
çdo ditë 6 p.m. – 9 a.m.
Një ekspert Shoqërisë Ključ do i përgjigjet telefonatave tuaja. Telefonata mund të jetë anonime

13. Marrja e shtetësisë/kombësisë

Shtetësia e fituar nëpërmjet lindjes dhe adoptimit

Një fëmijë i lindur në Slloveni është shtetas Slloven nëse njeri nga prindërit është shtetas Slloven.

Kur fëmija lind jashtë Sllovenisë, fëmija është automatikisht Slloven nëse:

- Te dy prindërit janë shtetas Sllovene; ose
- Një prind është Slloven dhe tjetri është pa shtetësi; ose
- Fëmija nuk ka ndonjë shtetësi tjetër.

Një fëmijë i lindur jashtë Sllovenisë me një nga prindërit shtetas Slloven mund të kërkojë shtetësi Sllovene nëpërmjet :

- Një aplikimi për t'u regjistruar si shtetas Slloven që bëhet në çdo kohë përpara moshës 36 vjeçare; ose
- Marrjes së lejes së qëndrimit të përhershëm të qëndrimit përpara moshës 18 vjeçare

Fëmijëve të adoptuar nga shtetas Sllovene mund t'ju jepet shtetësia Sllovene.

Shtetësia e fituar nëpërmjet natyralizimit

Një person mund të kërkojë shtetësi Sllovene nëpërmjet natyralizimit duke përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Një total prej 10 vjetësh qëndrimi në Slloveni duke përfshirë 5 vjet qëndrimi pa ndërprerje para dorëzimit të aplikimit
- Lënien e shtetësisë së huaj (ose paraqitja e provave që atë do ta humbasë automatikisht).
- Nivel shumë të mirë të njohjes së gjuhës Sllovene
- Karakter të mirë
- Moshë të paktën 18 vjeç
- Të ardhura të mjaftueshme në Slloveni sa për të mos kërkuar pagesa për përkrahje sociale

Përjashtime të kërkesave për natyralizim:

- Ata që kanë emigruar nga Sllovenia (dhe ata me prejardhje Sllovene deri në brezin e tretë) mund të natyralizohen pas një viti qëndrimi në Slloveni. Refuzim i shtetësisë së huaj nuk kërkohet sipas kësaj pike.
- Një person i cili është martuar me një shtetas Slloven për të paktën dy vjet mund të natyralizohet pas një viti qëndrimi në Slloveni
- Kërkesa për të refuzuar shtetësinë e huaj mund të hiqet me anë të një aplikimi të posaçëm.
- Një pezullim i përgjithshëm i kërkesave për natyralizim mund të behet për interesat kombëtare të Sllovenisë
- Një person me "origjinë Sllovene" ose një ish shtetas Slloven mund të natyralizohet pa plotësuar ndonjë prej kërkesave të qëndrimit

Fëmijët nën 18 vjeç mund të natyralizohen normalisht së bashku me prindërit e tyre nëse janë rezidentë në Slloveni. Fëmijët e moshës 14 vjeç ose më sipër duhet të japim pëlqimin e tyre.

Shtetësia e dyfishtë lejohet në Slloveni, me përjashtim të atyre rasteve që kërkojnë shtetësi Sllovene nga natyralizimi të cilëve iu kërkohet të heqin dorë nga çdo shtetësi e huaj që ata kanë.

14. Informacione dhe kontakte të tjera të nevojshme (kontaktet e ambasadave, faqet e internetit të ministrive në vendet pritëse dhe informacione të tjera)

Ambasada Shqiptare në Slloveni (Lubjanë)

Adresa: Zaloška cesta 69, 1000 Ljubljana
Tel: (+) 386 1 547 36 50
Fax: (+) 386 1 547 36 52

E-mail: embassy.ljubljana@mfa.gov.al

Ambasada e Bosnjë Hercegovinës në Slloveni (Lubjanë)

Adresa: Kolarjeva 26, SI-1000 Ljubljana
Tel: (+) 386 1 234 32 50
Fax: (+) 386 1 234 32 61
E-mail: ambihlju@siol.net

Ambasada Kroate dhe Zyra Konsullore në Slloveni (Lubjanë)

Adresa: Gruberjevo nabrezje 6 SI-1000 Ljubljana
Tel (+) 386 1 200 4401 (Consular Section : (+) 386 1 425 7287)
Fax: (+) 386 1 425 81 06
E-mail: croemb.slovenia@mvpei.hr

Ambasada Kroate dhe Zyra Konsullore në Slloveni (Maribor)

Adresa: Trg svobode 3 2000 Maribor
Tel: (+) 386 2 234 6680
Fax: (+) 386 2 234 6681
E-mail: [sime.ivanjko\(at\)uni-mb.si](mailto:sime.ivanjko(at)uni-mb.si)

Ambasada Kroate dhe Zyra Konsullore në Slloveni (Koper)

Adresa: Ferrarska 30, 6000 Koper
Tel: (+) 386 5 614 4011
Fax: (+) 386 5 614 4040
E-mail: bozo.dimnik@email.si

Ambasada Maqedonase në Slloveni (Lubjanë)

Adresa: Prešernova 2, SI-1000 Ljubljana
Tel: (+) 386 1 421 00 21
Fax: (+) 386 1 421 00 23
E-mail: makamb@siol.net

Konsullata Maqedonase në Slloveni (Kranj)

Adresa: Škofjeloška cesta 6 4000 Kranj
Tel: +386 4 206 52 15
Fax: +386 4 206 64 46
E-mail: janez.bohoric@sava.si

Ambasada e Malit të Zi në Slloveni (Lubjanë)

Adresa: Resljeva cesta 40, 1000 Ljubljana
Tel: (+) 386 1 439 53 64
Fax: (+) 386 1 439 53 60
E-mail: embamon-lj@t-2.net

Ambasada Serbe në Slloveni (Lubjanë)

Adresa: Slomškova ulica 1 SI-1000 Ljubljana
Tel: (+) 386 1 438 01 10

Fax:
E-mail:

(+) 386 1 434 26 88
amba.srbije.lju@siol.net